

SHOQËRIA ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
MARINA DI VALONASH.P.K
NË LOBBY HOME, RRUGA NACIONALE, TIRANË – ELBASAN, FARKE, LUNDER, TIRANË
REGJISTRUAR PRANË REGJISTRIT TREGTAR ME NUMËR IDENTIFIKIMI
M01324008A

VENDIM

I

ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË

Sot, më 30.09.2021, në selinë e Shoqërisë MARINA DI VALONA Sh.p.k. (më tej referuar si "Shoqëria"), mbahet mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë.

Është i pranishme Z. Geront Çela, i cila zotëron 100% të kapitalit të Shoqërisë (më tej referuar si "Ortaku i Vetëm"), i cili vepron në cilësinë e Kryetarit të Asamblesë

Kryetari i Asamblesë deklaroi vullnetin e Ortakut të Vetëm për të vendosur për çështjet në rendin e ditës, pavarësisht mungesës së njoftimit për thirrjen e asamblesë, e deklaroi Asamblesën e Përgjithshme të Shoqërisë të mbledhur rregullisht bazuar në paragrafin e dytë të nenit 83 të Ligjit n. 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe të aftë për të marrë vendime të vlefshme mbi rendin e ditës si në vijim:

RENDI I DITËS

- I. Miratimin e dorëheqjes së paraqitur nga Administratori i Shoqërisë z. Andi Pashaj;**
- II. Miratimi i administratorit të ri të Shoqërisë;**

* * * * *

Kryetari i Asamblesë, në lidhje me pikat e mësipërme të rendit të ditës, parashtron sa më poshtë.

I. MIRATIMIN E DORËHEQJES SË PARAQITUR NGA ADMINISTRATORI I SHOQËRISË Z. ANDI PASHAJ;

Në lidhje me pikën e parë në Rend të Ditës, parashtron se, meqenëse z. Andi Pashaj ka paraqitur dorëheqjen nga detyra me anë të "Kërkesë për Dorëheqje", në të cilën ai shpreh pamundësinë e tij objektive për vijimin e ushtrimit të funksioneve të administratorit të Shoqërisë për arsye personale, të cilat e detyrojnë atë të kërkojë dorëheqjen nga detyra, duke shprehur disponibilitetin e tij për të bërë dorëzimet e nevojshme dhe për të qëndruar në detyrë deri në momentin e emërimit të administratorit të ri. Në kushtet kur nga ana e z. Andi Pashaj është njoftuar pamundësia për vazhdimin e ushtrimit të funksioneve të administratorit, duke dhënë edhe argumentet përkatës në lidhje me këtë pamundësi mendojë se është e arsyeshme që kërkesa e tij të pranohet, duke kërkuar ushtrimin e funksioneve deri në momentin e dorëzimit të detyrës të administratorit të ri.

Pas një vlerësimi të kujdesshëm, Ortaku i Vetëm

VENDOSI:

TË MIRATOJË DORËHEQJEN E Z. ANDI PASHAJ NGA DETYRA E ADMINISTRATORIT, QË NGA DATA 30.09.2021.

II. MIRATIMI I ADMINISTRATORIT TË RI TË SHOQËRISË

Në lidhje me pikën e dytë në Rendit të Ditës, parashtron se miratimi i dorëheqjes së z. Andi Pashaj, nga detyra e administratorit të shoqërisë është shoqëruar me paraqitjen e një kandidature të re për kryerjen e kësaj detyre.

Z. Ervin Bacaj, lindur më 31.01.1980, në Vlore dhe banues në Vlore, mbajtës i letërnjoftimit me nr. I00131134S në detyrën e administratorit të Shoqërisë MARINA DI VALONA Sh.p.k., e cila ka një jetëshkrim të përshtatshëm për ushtrimin e funksioneve, një eksperiencë disa vjeçare në menaxhim dhe integritet të lartë moral. Si e tillë vlerësojmë këtë kandidaturë të përshtatshme për të ushtruar detyrën e administratorit të Shoqërisë.

Pas një vlerësimi të kujdesshëm, Ortaku i Vetëm

VENDOSI:

- 1 TË MIRATOJË EMËRIMIN E Z. ERVIN BACAJ, LINDUR MË 31.01.1980, NË VLORE DHE BANUES NË VLORE, MBAJTËS I LETERNJOFTIMIT NE NR. I00131134S, NË DETYRËN E ADMINISTRATORIT TË SHOQËRISË MARINA DI VALONA SH.P.K., PËR NJË AFAT 5 (PESE) VJEÇAR, I CILI FILLON EFEKTET NGA DATA 30/09/2021 DHE I PËRFUNDON MË DATË 30/09/2026;
- 2 AUTORIZOHET Z. ERVIN BACAJ NE CILËSINË E ADMINISTRATORIT TE SHOQËRISË QE, DUKE VEPRUAR PERSONALISHT OSE DUKE AUTORIZUAR PERSONA TE TJERË TE BEJ TE MUNDUR REGJISTRIMIN E KËTIJ VENDIMI NE QENDRËN KOMBËTARE TE BIZNESIT DHE NE ÇDO INSTITUCION TJETËR KU NJE REGJISTRIMI ËSHTË I KËRKUAR ME LIGJ.

* * * * *

Meqenëse nuk pati asnjë çështje tjetër për të diskutuar, Kryetari e deklaroi mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë të mbyllur në orën 11.30.

ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË

MARINA DI VALONA SH.P.K

Z. Geront Çela

Ortak i Vetëm



MARINA DI VALONA
M01324008A